



**Nr. Prot. 054/B/13**

## RREGULLORE

### PËR

### 'DHËNIEN DHE SHFRYTËZIMIN E RADIO FREKUENCAVE'

Kjo Rregullore nxjerrët në zbatim të dispozitave ligjore të përcaktuara sipas përcaktimeve të Kreut VII të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si; Ligji*), i cili përcakton parimet dhe rregullat bazë për menaxhimin e burimeve të komunikimeve elektronike, respektivisht spektrit radio frekuencor.

#### Neni 1

#### Qëllimi dhe Fushëveprimi i Rregullores

- 1.1. Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është i kufizuar në radio frekuencat/kanalet, gjegjësisht kapacitetet e resurseve frekuencore (*tutje referuar si; radio frekuenca*), që shfrytëzohen për radio komunikimet, të cilat, sipas Planit Kombëtar të Radio frekuencave menaxhohen nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Kosovës (*tutje referuar si Autoriteti*).
- 1.2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është për të përcaktuar procedurat dhe kushtet për:
  - 1.2.1. Ndarjen (përcaktimin) dhe shfrytëzimin e radio frekuencave;
  - 1.2.2. Ndërrimin e kushteve të shfrytëzimit të radio frekuencave;
  - 1.2.3. Zgjatjen e afatit për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave;
  - 1.2.4. Bartjen e të drejtave për shfrytëzim të radio frekuencave;
  - 1.2.5. Ndërrimin e radio frekuencave të përdorura;
  - 1.2.6. Heqjen e të drejtës për të shfrytëzuar radio frekuencat-eve;
  - 1.2.7. Anulimin e autorizimit;
  - 1.2.8. Procedurat e pagesës për aplikim dhe shfrytëzim të radio frekuencave.
- 1.3. Kjo rregullore vlen për të gjithë ndërmarrësit, operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe shfrytëzuesit që shfrytëzojnë apo kërkojnë të shfrytëzojnë shërbime të komunikimeve elektronike në territorin e Kosovës.

## Neni 2 Definicionet

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore janë të harmonizuara me përkufizimet e Ligjit, kurse shprehjet e tjera të përdorura paraqiten si në vazhdim;

- **Stacioni i radio komunikimeve fikse;** nënkupton stacion i radio komunikimeve, i zbatuar në mënyrë stacionare dhe që shfrytëzohet për instalim të pajisjes në vend specifik;
- **Stacioni i radio komunikimeve mobile** nënkupton stacion i radio komunikimeve, që ka për qëllim shfrytëzimin në lëvizje apo vendi i tij i shfrytëzimit mund të ndërrohet pa kryer ndonjë punë të instalimit të pajisjes në stacionin e radio komunikimeve;
- **Plani për Shfrytëzim të Radio Frekuencave;** nënkupton dokumentin e publikuar nga Autoriteti, i cili përcakton kushtet dhe qëllimin e shfrytëzimit të radio frekuencave;
- **Radio Frekuencë;** në këtë rregullore nënkupton kapacitetin frekuencor të një apo disa kanaleve frekuencore si dhe blloqet e brezeve frekuencore të cilat Autoriteti i shqyrton për mundësinë e dhënies së të drejtës së shfrytëzimit të tyre nga ndërmarrësit dhe/apo operatorët e autorizuar;
- **Radio frekuenca / kanali i lirë;** nënkupton një radio frekuence / kanal, i koordinuar me shtetet e huaja (në rast se një koordinim i tillë është i nevojshëm), me përjashtim të radio frekuenca, të shënuara si 'Te rezervuar' në Planin Kombëtar dhe Planin e Përdorimit të Radio Frekuencave, të aprovuar nga Autoriteti, i cili nuk ishte menduar për shfrytëzim në territor të caktuar, në bazë të së cilës asnjë vendim nuk është marrë nga Autoriteti për të përcaktuar radio frekuencën / kanalin për shfrytëzim në territorin e caktuar dhe kanali/radio frekuencor mund të përcaktohet të shfrytëzohet në kushte të caktuara, duke siguruar pajtueshmërinë elektromagnetike;
- **Autorizim (Autorizimi individual);** nënkupton dokumentin e shkruar, të lëshuar nga Autoriteti dhe/apo i regjistruar në bazën e të dhënave elektronike në dispozicion për publikun, i administruar nga Autoriteti, duke i dhënë të drejtën për të shfrytëzuar radio frekuencën/kanalin e specifikuar në pajtim me kushtet e specifikuara në/me autorizim dhe të bazuar nga aktet e aplikueshme ligjore;
- **Aplikacioni;** nënkupton një kërkesë për përcaktim të radio frekuencave, të përmendur në Nenin 4 Paragrafin 4.2) të kësaj Rregullore, të shoqëruara nga dokumentet e specifikuara në Paragrafin 4.3) në rast se dokumentet e tilla do duheshin të ofroheshin
- **Aplikuesi;** nënkupton personin, i cili ofron aplikacion për caktim të radio frekuencave drejtuar Autoritetit;
- **Shfrytëzuesi i radio frekuencave;** nënkupton personin, i cili ka të drejtën për shfrytëzim të radio frekuencave për zhvillimin e radio-komunikimeve.

### Neni 3

#### Procedura e Përgjithshme për dhënien (përcaktimin) dhe shfrytëzimin e radio frekuenca

- 3.1. Një radio frekuencë mund të përdoret pa autorizim individual në rast se ai përfshihet në Rregulloren e Autoritetit për Stacionet e Radio Komunikimeve për të cilat nuk është i nevojshëm Autorizimi Individual për radio frekuencë.
- 3.2. Me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit efikas dhe efektiv të burimeve të komunikimeve elektronike, kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, dhe të shmangies së interferencave të dëmshme, radio frekuenca, në përjashtim të atyre, të cilat mundën të përdoren pa autorizim individual, në pajtim me kushtet e parapara në Paragrafin 3.1) të këtij Neni, mundet të përdoret vetëm pas marrjes së autorizimit nga Autoriteti për shfrytëzim të radio frekuenca për qëllim dhe sipas kushteve të caktuara nga Autoriteti.
- 3.3. Qëllimi i shfrytëzimit të radio frekuencave, është paraparë në Planin Kombëtar të Radio Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Radio Frekuencave dhe dokumenteve të tjera, të miratuara nga Autoriteti.
- 3.4. Aplikacionet për Radio Frekuenca shfrytëzimi i të cilave është i dedikuar për shërbimet aeronautike dhe për të cilat paraprkasht kërkohet koordinimi ndërkombëtar me mekanizmat si; ICAO, EuroControl, etj. është në përgjegjësin e Autoritetit të Aviacionit Civil apo institucioneve tjera vendore relevante për kontroll ajror.
- 3.5. Autoriteti do të shqyrtoj aplikacionet për radio frekuenca vetëm pasi të jetë dokumentuar arritja koordinimit-eve ndërkombëtar-e nga autoritetet përgjegjëse të Aviacionit Civil dhe do të lëshoj Autorizimin për shfrytëzimin e radio frekuencave.
- 3.6. Radio frekuencat janë përcaktuar nga Autoriteti, i cili lëshon autorizime për shfrytëzim të radio frekuencave në pajtim me kushtet e caktuara duke i pasur parasysh obligimet kombëtare/ndërkombëtare, të ndërmarra nga Republika e Kosovës, Ligji, Rregulloret e Radio Komunikimeve, Planin Kombëtar të Radio Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Radio Frekuencave dhe akteve të tjera ligjore të miratuara nga Autoriteti, përfshirë planet për shfrytëzim dhe zhvillim të radio frekuencave.
- 3.7. Numri i autorizimeve për të shfrytëzuar radio frekuenca, për resurset frekuencore për të cilat 'Numri i autorizimeve për shfrytëzim të radio frekuenca është i kufizuar', përcaktohet me vendim-e të Autoritetit.
- 3.8. Autoriteti, pas pranimit të aplikacionit për caktim të radio frekuencave, mund të marr vendim të kufizoj numrin e autorizimeve për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave që konsiderohen specifike, në pajtim me procedurën dhe kushtet e përkufizuara sipas nenit 47, paragrafët 5) dhe 6) të Ligjit. Vendimi për resurset frekuencore ku numri i autorizimeve është i kufizuar i nxjerr nga autoriteti publikohet në ueb faqen e Autoritetit.

- 3.9. Kur Autoriteti vërteton që mund të përcaktohen radio frekuenca ku numri i autorizimeve është i kufizuar, atëherë Autoriteti bënë ftesë për shpalljen publike për paraqitje të aplikacioneve për radio frekuencave apo me iniciativën e vet shpallë një ankand publik për dhënien e të drejtës së shfrytëzimit të resurseve të komunikimeve elektronike.
- 3.10. Vendimet e Autoritetit në lidhje me caktimin, refuzimin për të caktuar, anulimin e caktimit dhe anulimin e autorizimeve për shfrytëzim të radio frekuencave për të cilat numri i autorizimeve është i kufizuar do të publikohen në ueb faqen e Autoritetit.
- 3.11. Radio frekuencat, të menduara për aktivitetet në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e shtetit, mirëmbajtjen e rendit publik, shërbimet e emergjencës, ruajtjen e kufirit shtetëror, sigurinë civile, sigurinë apo trafikun e hekurudhës, sigurimin stabil dhe të besueshëm të funksionimit të sistemit të energjisë dhe funksioneve të tjera jo komerciale të shtetit (përfshirë shtetet e huaja) dhe institucioneve të saja, do të caktohen në pajtim me dispozitat e Nenit 12 të kësaj Rregulloreje.
- 3.12. Radio frekuencat e menduara për shërbime të përkohshme (eksperimentale) dhe jo komerciale, do të caktohen në pajtim me dispozitat e Nenit 13 të kësaj Rregulloreje.
- 3.13. Në rastet kur të drejtat individuale për shfrytëzim të radio frekuencave janë dhënë për dhjetë (10) vite apo më tepër dhe gjatë kësaj periudhe kriteret e Autorizimit nuk janë më të aplikueshme, atëherë kushtet do të përcaktohen nga Autoriteti në pajtim me dispozitat e Nenit 54, paragrafi 7) të Ligjit.
- 3.14. Në rastet e parapara në paragrafin 3.11) të këtij Neni, Autoriteti duhet t'i bazoj veprimet e tija në rregullat dhe procedurat, e parapara në Nenet 8, 9, 10 të kësaj Rregulloreje.
- 3.15. Vendimet e Autoritetit në lidhje me përcaktimin dhe shfrytëzimin e radio frekuencave për të cilat numri i autorizimeve është i kufizuar, ndryshimin e kushteve për shfrytëzim të radio frekuenca, zgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit apo transferimin e të drejtave për përdorim do të publikohen në ueb faqen e Autoritetit. Dispozitat e këtij paragrafi mund të hiqen nëse radio frekuencat janë të caktuara dhe shfrytëzuara për aktivitetet e parapara në paragrafin 3.6) të këtij Neni.
- 3.16. Kërkesat dhe dokumentet e dorëzuara nga aplikuesi duhet të jenë në njërën nga gjuhët zyrtare apo gjuhë tjetër në rast se Autoriteti është në gjendje ta përkthejë dokumentin.
- 3.17. Kushtet e përgjithshme për shfrytëzim të radio frekuencave, të përcaktuara nga Autoriteti janë obligative për personat të cilët shfrytëzojnë radio frekuenca, përfshirë frekuencat të cilat mund të përdoren pa Autorizim Individual.
- 3.18. Këto rregulla nuk prejudikojnë kriteret për dizajnim, konstruktim, instalimin e pajisjeve dhe rregullat tjera për dizajnim dhe konstruktim të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

## Neni 4 Caktimi i radio frekuencave

- 4.1. Dispozitat e paragrafëve 4.8) dhe 4.13) të këtij neni mbi caktimin e radio frekuencave do të jenë të aplikueshme pas përcaktimit të brezeve për të cilat numri i autorizimeve është i kufizuar, përveç në rastet kur nuk është vendosur ndryshe nga Autoriteti.
- 4.2. Personi, i cili dëshiron të shfrytëzoj radio frekuenca me përjashtim të radio frekuencave, të cilat mund të përdoren pa ndonjë autorizim individual duhet t'i paraqes Autoritetit kërkesën me shkrim dhe aplikacionin-et varësisht nga shërbimi, sipas formave të cilat janë dhënë në Shtojcat 2) dhe 3) të kësaj Rregulloreje. Përveç të dhënave në kërkesë dhe aplikacion Autoriteti mban të drejtën të kërkoj nga aplikuesi plotësim të të dhënave shtesë.
- 4.2.1. Afati i vlefshmërisë për shfrytëzimin e radio frekuencave apo brezit të radio frekuencës nuk mund të jetë më i shkurtër se gjashtë (6) muaj, përveç rasteve të veçanta kur Autoriteti vendos që ai të jetë jo më i shkurtër se një (1) muaj duke përfshirë në këtë rast bashkimin e autorizimeve të shfrytëzuesit të njëjtë; Vlefshmëria e Autorizimit Individual, me e gjatë se 6 muaj do të jetë si shumëfish i periudhës 6 mujore.
- 4.3. Aplikuesi së bashku me kërkesën, të potencuar në paragrafin 4.2) të këtij neni duhet të ofroj edhe;
- 4.3.1. Dokumentet, të cilat dëshmojnë informatën mbi mundësinë për të ekzekutuar obligimet, në lidhje me shfrytëzimin e radio frekuenca, në rast se ato obligime dhe fushëveprimi i informatës së ofruar është specifikuar nga Autoriteti;
- 4.3.2. Kopja e dokumenteve, të cilat dëshmojnë që ndërmarrësi është i regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës për ofrim të shërbimeve. Në këtë rast, nëse aplikuesi është person juridik, i përbërë prej një grupi të personave juridik, çdo subjekt duhet t'i ofroj Autoritetit kopjet e regjistrimit të tyre legal (*së paku një subjekt duhet të jetë ligjërisht i regjistruar në Republikën e Kosovës*). Kur një ndërmarrës paraqet një aplikacion për caktim të burimeve të komunikimeve elektronike pasi që njoftimi mbi fillimin e aktivitetit të jetë dorëzuar Autoritetit, ndërmarrësi mundet në kohën e paraqitjes së aplikacionit, vetëm të konfirmoj që informatat dhe dokumentet e paraqitura më herët tek Autoriteti nuk kanë ndryshuar dhe nuk nevojitet të dorëzohen përsëri informatat dhe dokumentet e njëjta.

Nëse ndodhin ndryshime të tjera në aktivitetin e ndërmarrësit pas datës së paraqitjes së njoftimit mbi fillimin e aktivitetit që janë lëndë e akteve ligjore të Autoritetit, ndërmarrësi duhet të përditësoj dokumentet dhe informatat në kohën e aplikimit për caktim të burimeve të komunikimeve elektronike (*Ref. Neni 47 paragrafi 2 i Ligjit*).

- 4.4. Autoriteti, sa më shpejtë që është e mundur, pa prejudikuar në periudha kohore, të caktuar në nenin 47, paragrafët 10) dhe 11) të Ligjit, do të shqyrtoj aplikacionin dhe filloj procedurën e koordinimit të radio frekuencave (në rast se një procedurë e tillë është e nevojshme) deri në kompletimin e të dhënave dhe dokumenteve të nevojshme. Autoriteti brenda dhjetë (10) ditëve do t'ia përcjellë aplikuesit njoftimin si me poshtë me njërin nga vendimet e marra;
- 4.4.1. Të caktoj radio frekuenca në rast se nuk është marrë ndonjë Vendim për kufizimin e numrit të autorizimeve apo në rast se radio frekuenca është caktuar në pajtim me dispozitat e Nenit 12) apo 13) të kësaj Rregulloreje;
- 4.4.2. Të bëjë shpallje në web faqen e Autoritetit dhe të informoj të interesuarit për mundësinë për të aplikuar për caktim të radio frekuencave të dëshiruara nga aplikuesi, në rast të Vendimit të marrë për kufizim të numrit të autorizimeve për shfrytëzim të radio frekuencave;
- 4.4.3. Të shpall tender publik apo ankand;
- 4.4.4. Të refuzoj caktimin e radio frekuencave në rastet si në vijim;
- 4.4.4.1. Nuk ka kapacitete të lira frekuencore në dispozicion;
- 4.4.4.2. Aktivitetet e aplikuesit dështojnë të jenë në pajtim me Ligjin, aktet e tjera ligjore, që rregullojnë aktivitetet e komunikimeve elektronike apo kriteret e tenderit/ ankandit publik;
- 4.4.4.3. Aplikuesi tashmë nuk është duke shfrytëzuar në mënyrë efikase radio frekuencat që i janë caktuar;
- 4.4.4.4. Aplikuesi dështon të dorëzoj dokumentet e nevojshme apo informatat e kërkuara nga Autoriteti;
- 4.4.4.5. Informatat e ofruara apo dokumentet dështojnë të jenë në përputhje me kriteret e caktuara, janë me gabime apo jo të sakta;
- 4.4.4.6. Nëse aplikuesi nuk e përmbushë pagesën brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti;
- 4.4.4.7. Nëse përcaktimi i radio frekuencave është i pa arritshëm si shkak i koordinimit me institucione kombëtare/ndërkombëtare.
- 4.4.5. Përcaktimi i radio frekuencave mund të prolongohet përtej afateve kohore të përcaktuar me këtë Rregullore dhe Ligj si shkak (rezultat) i koordinimit me institucione kombëtare/ndërkombëtare me Autoritetin në të cilin proces aktiviteti i Autoriteti nuk mund të ndikojnë në përsheptimin e tij. Pasi që Autoriteti, në pajtim me paragrafin 4.4) të këtij neni, fillon procedurën e koordinimit të radio frekuencave, do ta informoj aplikuesin mbi procesin e koordinimit brenda një periudhe kohore prej dhjetë (10) ditëve të punës.
- 4.5. Para marrjes së vendimit për refuzim e caktimit të radio frekuencave për aplikuesin, Autoriteti ka të drejtë të caktoj periudhën kohore prej një (1) muaji, gjatë së cilës aplikuesi duhet t'i eliminoj rrethanat të cilat e pengojnë marrjen e njërit nga vendimet e specifikuar në nënparagrafët 4.4.1);, 0); apo 4.4.3); të këtij neni.



Autoriteti e njofton aplikuesin mbi kushtet e pa-përmbushura dhe mund ti lejoj një afat shtesë kohor për përmbushjen e tyre.

- 4.6. Në rast të pamundësisë së përcaktimit të frekuencave/kanaleve në pajtim me kushtet, e specifikuar në aplikacion, Autoriteti, sipas procedurës, të parapara në paragrafin 4.6) të këtij neni do të informoj aplikuesin mbi çështjen, duke specifikuar kushtet, mbi të cilat Autoriteti mund të filloj procedurën e përcaktimit të radio frekuencave. Në rast se aplikuesi brenda periudhës kohore të specifikuar nga Autoriteti pohon që kushtet e propozuara nuk janë të kënaqshme apo nuk ofron përgjigje, Autoriteti merr vendimin për të refuzuar caktimin e radio frekuencave bazuar në përcaktimet e parapara me nën-paragrafin 4.4.4) të këtij neni. Në rast se aplikuesi pajtohet me kushtet e propozuara, Autoriteti do t'i përcaktoj radio frekuenca mbi kushtet e propozuara në pajtim me procedurën, të caktuar në paragrafët 4.4) dhe 4.9) të kësaj Rregulloreje.
- 4.7. Autoriteti, me rastin e njoftimit për mundësinë e paraqitjes së aplikacioneve për caktimin e radio frekuencave në pajtim me paragrafin 3.7) të nenit 3) apo nën-paragrafit 4.4.2) të këtij neni, do të specifikoj kushtet kryesore për shfrytëzim të radio frekuenca dhe periudhën kohore të pranimit të aplikacioneve.
- 4.8. Aplikacionet, të paraqitura në pajtim me paragrafin 3.7) të nenit 3) apo nën-paragrafit 4.4.2) të këtij neni duhet të jenë në përputhje me kriteret, të parapara në paragrafët 4.2) dhe 4.3) të këtij neni. Autoriteti, pas pranimit të aplikacioneve të tilla mund të refuzoj caktimin e radio frekuenca në pajtim me nën-paragrafët; 4.4.4.2);, 4.4.4.3);, 4.4.4.4); dhe/apo 4.4.4.5); të këtij neni.
- 4.9. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas datës së skadimit për pranim të aplikacioneve, Autoriteti me shkresë të veçantë (ose Vendim) për caktimin e radio frekuencave do të informoj aplikuesin, të cilët në mënyrë të rregullt i kanë paraqitur aplikacionet e tyre brenda periudhës kohore të përshkruar nga Autoriteti, dhe nuk ka kërkesa nga aplikues të tjerë për të marrë radio frekuenca apo në rast se radio frekuencat e dëshiruara mund t'u caktohen të gjithë aplikuesve.  
  
Personat, të cilëve Autoriteti refuzon t'u caktoj radio frekuenca, në pajtim me nën-paragrafin 4.4.4) të këtij neni, nuk do të mbahen të regjistruar si aplikues.
- 4.10. Në rast se Autoriteti pranon me tepër aplikacione me kërkesa që tejkalojnë kapacitet radio frekuencore nga ato që janë të parapara të caktohen brenda periudhës kohore të caktuar nga Autoriteti, procesi i përcaktimit të radio frekuencave do t'u caktohen me procedurë të tenderit publik apo ankandit.
- 4.11. Tenderi Publik apo Ankandi do të aranzhohet në pajtim me procedurat, të caktuara në përputhje me dispozitat e Ligjit. Autoriteti përgatit draftin e kushteve të tenderit publik, të cilat në pajtim me nenin 50) të Ligjit, do të aprovohen nga Ministria. Rregullat për Ankand në pajtim me nenin 51 paragrafi 1) të Ligjit do të caktohen nga Autoriteti.

- 4.12. Vendimi i Autoritetit për caktim të radio frekuenca mund të përmbajë kushtet kryesore pa hyr në detajet teknike që përmban autorizimi për shfrytëzim të radio frekuencave.
- 4.13. Autoriteti, para lëshimit të autorizimit për shfrytëzim të radio frekuencave, mund të kërkojë informata shtesë, të nevojshme për vlerësim të përputhshmërisë me kriteret mbi pajtueshmërinë elektromagnetike të stacionit të radio komunikimit, në të cilin radio frekuenca do të përdoret në përputhje me Rregulloren Teknike për radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese.
- 4.14. Autoriteti i cakton kushtet për shfrytëzimin e radio frekuencave dhe i lëshon autorizimin vetëm pasi që fituesi i tenderit publik/ankandit apo aplikuesit të cilin autoriteti e ka informuar mbi vendimin e tij për caktimin e radio frekuencave;
- 4.14.1. Ka realizuar pagesat, të përcaktuara nga Autoriteti në llogarinë zyrtare të Autoritetit;
- 4.14.2. Ka siguruar informatat shtesë, në rast se një informatë e tillë është kërkuar në pajtim me paragrafin 4.14) të këtij neni;
- 4.14.3. Ka ofruar shënimet /të dhënat e pjesës radio-teknike të stacionit të radio komunikimeve, në rast se një shënim/e dhënë e tillë nevojitet në pajtim me kërkesat e nenit 5) të kësaj Rregulloreje.
- 4.15. Fituesi i tenderit publik/ankandit apo aplikuesi do të realizojë pagesat në llogarinë e Autoritetit, si të parapara në paragrafin 4.15.1) të kësaj Rregulloreje, duke specifikuar qëllimin e pagesës dhe të dorëzoj informatat shtesë jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së Vendimit nga Autoriteti për caktimin e radio frekuencave, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me ndonjë vendim tjetër.
- 4.16. Autoriteti përmes vendimit të tij mund të refuzoj lëshimin e autorizimit për shfrytëzim të radio frekuencave dhe/apo të anuloj vendimin korrespondues për caktim të radio frekuencave në rastet si në vijim;
- 4.16.1. Fituesi i tenderit publik/ankandit apo aplikuesi dështon të zbatoj kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave, të parapara në vendimin e Autoritetit për caktim të radio frekuencave;
- 4.16.2. Fituesi i tenderit publik/ankandit apo aplikuesi dështon të ofroj informatat e kërkuara gjatë periudhës kohore të caktuar, në pajtim me paragrafin 4.14) të këtij neni;
- 4.16.3. Autoriteti pasi që ka shqyrtuar informatat e pranuar, në pajtim me paragrafin 4.14) të këtij neni, vërteton që aplikuesi ka dështuar të siguroj kompatibilitetin elektromagnetik të stacionit të radio komunikimeve;
- 4.16.4. Pajisja, e planifikuar për shfrytëzim dështon t'i përmbush kriteret e parapara me Rregulloren Teknike për radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese;



- 4.16.5. Informatat e ofruar në pajtim me paragrafin 4.14) të kësaj Rregulloreje dështon të jetë në përputhje me kushtet e caktuara për shfrytëzim të radio frekuencave, të specifikuara gjatë caktimit të radio frekuencave;
- 4.16.6. Aplikuesi dështon t'i ofroj Autoritetit shënimet apo të dhënat e korrigjuara të pjesës teknike të radio pajisjes të stacionit të radio komunikimeve për ekzaminim e përsëritur, brenda periudhës kohore të caktuar nga Autoriteti si në paragrafin 5.6) të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
- 4.16.7. Fituesi i tenderit publik/ankandit apo aplikuesi dështon të realizoj pagesat e caktuara nga Autoriteti, për të cilat aplikuesi si fitues i tenderit publik/ankandit është pajtuar t'i paguaj, para lëshimit të autorizimit.
- 4.17. Në rast se Autoriteti refuzon t'i lëshoj autorizimin fituesit të tenderit publik/ankandit për shkak të mos përmbushjes së kushteve të parapara, gjitha pagesat e kryera nga aplikuesi nuk do të imbursohen (kthehen).

## **Neni 5**

### **Aplikacioni me shënimet dhe të dhënat e pjesës radio - teknike të stacionit të radio komunikimeve**

- 5.1 Aplikacioni me shënimet dhe të dhënat e pjesës radio teknike të stacionit të radio komunikimeve duhet të përgatiten dhe t'i dorëzohet Autoritetit në rast se një kusht i tillë është i paraparë nga Autoriteti me rastin e caktimit të radio frekuencave apo në rastin e ndryshimit të kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave.
- 5.2 Aplikacioni me shënimet dhe të dhënat duhet të jenë në përputhje me kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave, të caktuara me kërkesë të Autoritetit për caktim apo ndryshim të radio frekuencave. Aplikacioni me skemat e lidhjes se sistemeve transmetuese duhet të dorëzohet për koordinim brenda tre (3) muajve nga data e kërkesës përkatëse të Autoritetit, përderisa nuk është specifikuar ndryshe nga Autoriteti.
- 5.3 Aplikacioni me shënimet dhe të dhënat duhet të përfshijë;
- 5.3.1 Listën e pajisjeve të radio komunikimit të paraparë për shfrytëzim, karakteristikat dhe specifikat teknike të pajisjes, diagrami i rrjetës dhe skemat e lidhjes të linjave të bartjes së sinjalit me antenat dhe burimet e sinjalit si dhe informatat mbi pajtueshmërinë e pajisjes me kriteret, të paraqitura në Rregulloren Teknike për Radio-pajisjet dhe Pajisjet Terminale Telekomunikuese.
- 5.3.2 Autoriteti rezervon të drejtën për të kërkuar të dhëna shtesë.

- 5.4 Autoriteti do të shqyrtoj aplikacionin jo më vonë se brenda periudhës kohore prej 42 ditësh prej datës së pranimit të (projektit) skemat te kompletuar e lidhjes se sistemeve transmetuese te dhe të marrë një nga vendimet në vijim;
- 5.4.1 Të refuzojë aplikacionin, duke ofruar shpjegim të motivuar aplikuesit, në rastet si në vijim;
- 5.4.1.1 Aplikacioni dështon të jetë në përputhje me së paku njërin nga kriteret, të parapara në paragrafët 5.2 apo 5.3 të kësaj Rregulloreje;
- 5.4.1.2 Aplikacioni dështon të jetë në përputhje me ndonjërin prej kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave;
- 5.4.1.3 Informatat, e paraqitura në aplikacion dështojnë të jenë në përputhje me karakteristikat teknike, të parapara në përshkrimet teknike të pajisjes së radio komunikimit dhe nuk është e arsyetuar në ndonjë mënyrë tjetër.
- 5.5 Pasi që Autoriteti të ketë refuzuar aplikacionin, nëse kërkohet kopja origjinale e aplikacionit e njëjta do i kthehet prapa aplikuesit me letrën përcjellëse nga Autoriteti.
- 5.6 Në rast se Autoriteti refuzon aplikacionin, aplikuesi do të ketë të drejtën të ndryshojë atë dhe t'ia ofroj Autoritetit për ekzaminim të serishëm jo më vonë se brenda tre (3) muajve nga data e refuzimit të Autoritetit, vetëm nëse Autoriteti specifikon ndryshe.

## **Neni 6**

### **Autorizimi dhe kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave / kanaleve**

- 6.1 Autorizimi për shfrytëzim të radio frekuencave i lëshohet personave, në lidhje me të cilët Autoriteti ka konstatuar se janë plotësuar kushtet apo ka marrë vendimin për caktim të radio frekuencave.
- 6.2 Autorizimi për të përdorur radio frekuenca përmban specifikacionet si në vijim;
- 6.2.1 Radio frekuencat dhe / apo brezin e radio frekuencës;
- 6.2.2 Numri i autorizimit dhe Datën e fillimit të shfrytëzimit të radio frekuencave;
- 6.2.3 Shfrytëzuesin e radio frekuencave dhe detajet e kontaktit;
- 6.2.4 Klasën e stacionit dhe mënyrën e operimit;
- 6.2.5 Fuqinë transmetuese te pajisjes, gjerësinë e kanalit frekuencor/brezit dhe dizajnin e transmetimit;
- 6.2.6 Llojin e radio pajisjeve apo pajisjeve terminale te telekomunikimit;
- 6.2.7 Qëllimin e përdorimit të radio frekuencave;
- 6.2.8 Vendndodhjen e stacionit te radio komunikimeve fiks dhe territorin e shfrytëzimit të radio frekuencave;
- 6.2.9 Periudha kohore e vlefshmërisë së të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave. Periudha kohore duhet të përputhet me karakterin e shërbimeve dhe nuk mundet me qenë më gjatë sesa që është e specifikuar në aplikacion të aplikantit për caktim të radio frekuencave.

- 6.3 Autoriteti do të caktojë kushtet në vijim për shfrytëzim të radio frekuencave, të cilat mund të ndryshohen, në pajtim me rregullat dhe procedurat e caktuara në Nenin 8 të Rregullores:
- 6.3.1 Shfrytëzuesi duhet t'i respektojë kushtet e autorizimit paraprak në pajtim me procedurën dhe nën kushtet e specifikuar në autorizim, deri në lëshimin e autorizimit të ri me kushte të ndryshuara; Të përgatis dhe t'ia paraqes Autoritetit projektin e pjesës radio - teknike të stacionit fiks radio komunikues për koordinim;
- 6.3.2 Kushtet e tjera pa prejjudikuar përcaktimet e përkufizuara sipas dispozitave të paragrafit 2) të nenit 54) të Ligjit.

## **Neni 7**

### **Shfrytëzimi i Radio Frekuencave**

- 7.1 Bartësi i autorizimit duhet të shfrytëzojë frekuencat në mënyrë efikase. Kriteret e efikasitetit të shfrytëzimit të radio frekuencave janë si në vijim;
- 7.1.1 Një radio frekuencë duhet të fillojë të përdoret jo më vonë se brenda periudhës kohore prej gjashtë (6) muajsh nga data e lëshimit të autorizimit për të shfrytëzuar radio frekuencën, në rast se asnjë kusht tjetër nuk është paraqitur në autorizim lidhur me këtë çështje. Autoriteti nuk lejon që radio frekuencat të mbahen nga shfrytëzuesi kur ato nuk shfrytëzohen në mënyrë efikase përpos në rastin kur shfrytëzuesi i radio frekuencës/kanaleve me iniciativë të vet, duke i dhënë një njoftim paraprak Autoritetit ndërprejnë shfrytëzimin e radio frekuencave për periudhë kohore, dhe atë jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj rresht, dhe jo më gjatë se nëntë (9) muaj gjatë një viti kalendarik;
- 7.1.2 Të respektohen termat dhe kushtet e shfrytëzimit të radio frekuencave;
- 7.1.3 Gjatë operimit të radio frekuencës të mos i shkaktohet asnjë interferencë radio shfrytëzuesve tjerë;
- 7.1.4 Parametrat e rrezatimit të stacionit transmetues duhet të respektohen, nëse janë kërkuar konform nenit 5) të kësaj Rregulloreje;
- 7.1.5 Të respektohen normat dhe parametrat teknik për rrezatimin jo-jonizues të stacioneve transmetuese të përcaktuar me rekomandimet evropiane, ITU-së si dhe ICNIRP;
- 7.1.6 Kriteria tjera, të cilat janë të specifikuar nga Autoriteti apo të përcaktuara me akte tjera ligjore për të shfrytëzuar radio frekuencat.
- 7.2 Në rast se u shkaktohen interferenca shfrytëzuesve të radio frekuencave, interferencat duhet të eliminohen në pajtim me Procedurën e Identifikimit dhe Eliminimit të Radio Interferencave.

- 7.3 Në rast të kërkesës nga Autoriteti, shfrytëzuesi i radio frekuencave duhet të krijojë kushtet për përfaqësuesit e Autoritetit për të inspektuar pajisjen e stacionit të radio komunikimeve dhe të kontrollojë nëse stacioni i radio komunikimeve është në përputhje me projektin e pjesës radio teknike, respektimin e kushteve të shfrytëzimit të radio frekuencave nga shfrytëzuesi i radio frekuencave, apo të ofrojë informata të nevojshme për identifikim të stacionit transmetues/pranues.
- 7.4 Në rast kur Autoriteti përcakton që shfrytëzuesi i radio frekuencave dështon të respektojë kushtet e shfrytëzimit të radio frekuencave, Autoriteti e informon me shkrim shfrytëzuesin e radio frekuencave rreth shkeljeve të identifikuar dhe i ofron shfrytëzuesit mundësinë për të shprehur mendimin e tij brenda;
- 7.4.1 Një muaji nga data e dërgesës së njoftimit;
- 7.4.2 Periudhës tjetër kohore të arsyeshme, të përcaktuar nga Autoriteti, që nuk e tejkalon datën e skadimit të autorizimit korrespondues.
- 7.5 Autoriteti ka të drejtë të kërkojë nga shfrytëzuesi i radio frekuencave të ndërpresë shkeljen, menjëherë apo brenda një periudhe kohore të arsyeshme, të caktuar nga Autoriteti. Në rast të mos ndërprerjes Autoriteti do të ndërmarrë hapa të duhura dhe proporcionale për të siguruar respektimin e akteve ligjore, duke përfshirë imponimin e sanksioneve ekonomike, në pajtim me nenet 99 dhe 101 të Ligjit. Autoriteti jo më vonë se brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e vendimit do të informojë shfrytëzuesin e radio frekuencave mbi masat që duhet të ndërmerren dhe arsyet e marrjeve të masave të tilla, duke caktuar një kohë proporcionale për shfrytëzuesin e radio frekuencave për të zbatuar masat.
- 7.6 Në rast se Autoriteti ka dëshmi mbi shkeljet e kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave, në pajtim me paragrafin 5) të nenit 99 të Ligjit, ka të drejtë të ndërmarrë masa të përkohshme urgjente, pa i zbatuar dispozitat e paragrafëve 7.4) dhe 7.5) të këtij neni.
- 7.7 Shfrytëzuesi i radio frekuencave, ndaj të cilit janë aplikuar masat e përmendura në paragrafin 7.6) të këtij neni, mundet që gjatë periudhës kohore të aplikimit të masave t'ia paraqes arsyetimin e vet Autoritetit dhe të propozojë masat për të zgjidhur situatën. Autoriteti mund të marrë parasysh propozimin e shfrytëzuesit të radio frekuencave dhe të zëvendësoj masën urgjente të aplikuar me ndonjë tjetër.
- 7.8 Duke pas të njohur që radio frekuencat janë shfrytëzuar në mënyrë jo efikase dhe jo efektive dhe (apo) konkurrenca është shtrembëruar nga ndonjë transfer apo akumulim i të drejtave për të shfrytëzuar radio frekuencat, Autoriteti, në pajtim me paragrafin 8) të nenit 54 të Ligjit, mund të ndërmarrë masa adekuate duke urdhëruar shitjen apo dhënien me qira të të drejtave për të shfrytëzuar radio frekuencat.

## Neni 8

### Ndryshimi i kushteve për të shfrytëzuar radio frekuencat

- 8.1 Kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave, të aprovuara nga Autoriteti mund të ndryshohen në ndonjërin nga rastet në vijim;
- 8.1.1 Me kërkesë të shfrytëzuesit të radio frekuencave në pajtim me procedurën, të paraparë me nenet 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje;
- 8.1.2 Me iniciativë të Autoritetit në pajtim me procedurën dhe sipas kushteve të parapara në paragrafin 8.6) të këtij neni.
- 8.2 Shfrytëzuesi i radio frekuencave, që dëshiron të ndërrojë kushtet e caktuara nga Autoriteti, përveç për vazhdim të periudhës kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave (*shih nenin 9*), duhet, jo më vonë se tre (3) muaj para skadimit të periudhës kohore të vlefshmërisë së të drejtës për shfrytëzim të frekuencave, t'i ofrojë Autoritetit një kërkesë të arsyeshme e cila duhet të përmbajë çështjet e specifikuar si në vijim;
- 8.2.1 Datën e lëshimit dhe numrin e autorizimit për shfrytëzim të radio frekuencave, kushtet e të cilit shfrytëzuesi dëshiron t'i ndryshojë;
- 8.2.2 Kushtet e reja për shfrytëzim të radio frekuencave, të cilat shfrytëzuesi i radio frekuencave kërkon të aplikohen, e qe duhet te jene te specifikuar ne aplikacion;
- 8.2.3 Pëlqimin e personit, i cili kërkon që e drejta për të shfrytëzuar radio frekuencat ti nënshtrohet ndryshimit të kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave, kur kërkesa dhe aplikacioni për ndryshim të shfrytëzimit të frekuencave i është dorëzuar Autoritetit.
- 8.2.4 Dokumentet, bazuar në motivet e kërkesës.
- 8.3 Autoriteti mund të përcaktojë një periudhë kohore prej deri në dhjetë (10) ditë pune, gjatë së cilës shfrytëzuesi i frekuencës duhet të qartësoj apo ofrojë informata shtesë, të nevojshme për qëllim të marrjes së vendimit në lidhje me ndryshimin e kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave. Në rast se shfrytëzuesi i radio frekuencave dështon të qartësojë apo të ofrojë informata brenda kësaj periudhe kohore, Autoriteti do të refuzojë ndryshimin e kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave.
- 8.4 Autoriteti jo më vonë se brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditëve, si datë e pranimit të dokumenteve dhe informatave, të specifikuar në paragrafët 8.2) dhe 8.3) të këtij Neni do të shqyrtojë kërkesën dhe të ndër marr njërin nga veprimet në vijim, me ç'rast shfrytëzuesi i radio frekuencave do të informohet brenda dhjete (10) ditëve të punës;
- 8.4.1 Përcakton kushtet lidhur me shfrytëzimin e radio frekuencave në rast se ndryshimet janë minore dhe nuk e ndryshojnë substancën rregulluese në pajtim me shfrytëzuesin e radio frekuencës (kanalit);

- 8.4.2 Të inicioj këshillimin publik lidhur me vendimin, përmes të cilit ndërrojnë kushtet për shfrytëzimin e radio frekuencave dhe fillon procedura e koordinimit kombëtar/ndërkombëtar, nëse është e nevojshme;
- 8.4.3 Refuzon ndryshimin e kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave, duke e arsyetuar një veprim të tillë në ndonjërin nga rastet vijuese;
- 8.4.3.1 Ndryshimi i kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave do të ishte në konflikt me obligimet e parapara me autorizim apo kushtet e tenderit/ankandit, obligimeve kombëtare/ndërkombëtare dhe/apo akteve ligjore, të cilat i rregullojnë aktivitetet e komunikimeve elektronike;
- 8.4.3.2 Ndryshim i kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave do të rezultonte në dështim për të siguruar kompatibilitetin elektromagnetik, përfshirë kompatibilitetin elektromagnetik të pajisjes së radio komunikimit e cila shfrytëzon radio frekuencat, lidhur me të cilat Autoriteti ka marrë vendim për të caktuar radio frekuencën apo ka filluar procedurën e përcaktimit të radio frekuencave;
- 8.4.4 Paraqet refuzim të arsyeshëm për ndryshim të kushteve të shfrytëzimit të radio frekuencave/kanaleve, në rast se shfrytëzuesi i radio frekuencave/kanaleve ia paraqet kërkesën Autoritetit jashtë afatit të specifikuar në paragrafin 8.2) të këtij neni.
- 8.5 Pas përfundimit të procedurës për koordinim të radio frekuencave dhe këshillimit publik, të përmendur në paragrafin 8.4.1) të këtij Neni, sidoqoftë jo më vonë se deri në skadim të periudhës kohore për të shfrytëzuar radio frekuencën korrespondues, Autoriteti do të marrë një nga veprimet në vijim, me ç'rast shfrytëzuesi i radio frekuencave do të informohet brenda pesë (5) ditëve të punës;
- 8.5.1 Për ndryshimin e kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave. Duke e marrë një veprim të tillë, Autoriteti mund të specifikojë kushtet sipas të cilave shfrytëzuesi i radio frekuencës duhet të përgatit apo ndryshoj projektin e pjesës radio-teknike të stacionit të radio komunikimeve dhe të koordinoj atë me autoritetin;
- 8.5.2 Duke marrë parasysh rezultatet e koordinimit ndërkombëtar dhe të komenteve të pranuar apo vërejtjet dhe kundërshtimet, refuzon të ndryshojë kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave.
- 8.6 Në rastet kur shfrytëzimi efikas i radio frekuencave arsyetohet në mënyrën e duhur, në rast se kërkohet nga traktatet ndërkombëtare apo në rast se qëllimi për resurse të komunikimeve elektronike ndryshon, Autoriteti do të ketë të drejtën sipas iniciativës së vet, të ndryshojë kushtet e shfrytëzimit të radio frekuencave, të specifikuar në autorizim. Shfrytëzuesi i radio frekuencave do të informohet mbi një ndryshim të tillë të planifikuar dhe drafti i vendimit do të konsultohet publikisht. Vendimi për të ndryshuar kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave



apo refuzimi për të marrë vendimin do të bëhet duke pasur parasysh komentet e pranuar gjatë konsultimit.

- 8.7 Në rast se shfrytëzuesi i radio frekuencave dështon të realizoj pagesat e caktuara nga Autoriteti brenda periudhës kohore të specifikuar në aktet ligjore, afati për marrjen e vendimit për të ndryshuar radio frekuencat (kanalet) të specifikuar në paragrafët 8.4) apo 8.5) të këtij Neni, vazhdohet për tridhjetë (30) ditë apo deri në përfundim të afatit të radio frekuencave (kanaleve). Në rast se shfrytëzuesi i radio frekuencave dështon të paguaj pagesat brenda kësaj periudhe kohore, Autoriteti refuzon të ndryshoj kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave.

## Neni 9

### Vazhdimi i periudhës së vlefshmërisë për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave

- 9.1 Një shfrytëzues i radio frekuencave, që dëshiron të vazhdoj periudhën kohore (afatin) për të shfrytëzuar radio frekuencat, duhet JO më vonë se tridhjetë (30) para skadimit të vlefshmërisë së të drejtës për të shfrytëzuar frekuencat, t'i paraqesë Autoritetit një kërkesë të arsyeshme, e cila është paraqitur në Shtojcën 2) të kësaj Rregulloreje. Kërkesa duhet të përmbaj datën e lëshimit dhe numrin e autorizimit, si dhe datën deri në të cilën shfrytëzuesi dëshiron të vazhdoj periudhën kohore (afatin) për të shfrytëzuar radio frekuencat.
- 9.2 Autoriteti mund të caktoj një periudhë kohore shtesë prej më së shumti dhjetë (10) ditëve pune, gjatë së cilës shfrytëzuesi i frekuencave duhet të qartësoj apo ofroj informata shtesë, të nevojshme për qëllimin e marrjes së vendimit në lidhje me vazhdimin e periudhës kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave. Në rast se shfrytëzuesi dështon të qartësoj apo ofroj informata shtesë brenda kësaj periudhe kohore, Autoriteti refuzon të vazhdoj periudhën e vlefshmërisë së autorizimit për shfrytëzimin e radio frekuencave.
- 9.3 Autoriteti jo më vonë se brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të dokumenteve dhe informatave, të specifikuar në paragrafët 8.2) dhe 8.3) të nenit 8, do të shqyrtoj kërkesën dhe do të ndërmerrij njërin nga veprimet në vijim, mbi të cilat shfrytëzuesi i radio frekuencës do të informohet brenda dhjetë (10) ditëve të punës;
- 9.3.1 Në rast se me Vendim të Autoritetit është caktuar që numri i autorizimeve për radio frekuenca është apo do të kufizohet, atëherë Autoriteti do të iniciojë këshillim publik në lidhje me vendimin për të vazhduar periudhën kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave;
- 9.3.2 Në rast se nuk është përcaktuar që numri i autorizimeve për radio frekuenca të veçanta do të limitohet, Autoriteti merr vendim për të vazhduar periudhën kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave;
- 9.3.3 Refuzon kërkesën për të vazhduar periudhën kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave, duke e arsyetuar një qëndrim të tillë (*p.sh. nëse nuk janë respektuar periudhat kohore për të paraqitur kërkesën, etj*).

- 9.4 Pas përfundimit të këshillimit publik, të paraparë sipas nën-paragrafit 9.3.1) të këtij neni, jo më vonë se deri në skadim të vlefshmërisë së periudhës kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave korrespondues, Autoriteti do të marrë një nga vendimet në vijim, për të cilat shfrytëzuesi i radio frekuencave do të informohet brenda dhjetë (10) ditëve të punës;
- 9.4.1 Të vazhdohet periudha kohore e vlefshmërisë për shfrytëzimin e radio frekuencave në rast se shfrytëzuesi i ka respektuar kushtet për shfrytëzim të radio frekuencave për tri (3) vitet e kaluara dhe ekziston njëri nga rastet e mëposhtme;
- 9.4.1.1 Nuk janë pranuar komente të arsyetuara apo vërejtje apo kundërshtime (*për shkak të cilave nuk është i mundur shfrytëzimi i mëtutjeshëm i radio frekuencave, apo nuk kanë shprehur kërkesa persona të tjerë për të shfrytëzuar radio frekuencat apo ekziston numër i mjaftueshëm i radio frekuencave për t'iu alokuar të gjithë personave, të cilët kanë shprehur kërkesën e tyre*) gjatë konsultimit publik, të përmendur në nën-paragrafin 9.3.1) të këtij neni;
- 9.4.1.2 Radio frekuencat për të cilat është pranuar kërkesa për vazhdim të periudhës kohore të shfrytëzimit, janë përdorur për ofrimin e komunikimeve në rrjete publike dhe ndryshimi i shfrytëzuesit të këtyre radio frekuencave mund të ngrit probleme serioze ekonomike, sociale apo aktivitete të ndërlidhura tek shfrytëzuesit e rrjetit publik telekomunikues dhe/apo shërbimeve të komunikimeve elektronike. Ky paragraf do të jetë i aplikueshëm vetëm në rast kur kushtet e tjera nuk janë ndryshuar gjatë ndërrimit të periudhës kohore për shfrytëzim të radio frekuencave;
- 9.4.1.3 Në rast se pranohen kërkesa/interesim për ato resurse frekuencore, apo komente, vërejtje apo kundërshtime të arsyetuara nga palët tjera gjatë këshillimit publik, Autoriteti refuzon të vazhdoj periudhën kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave.
- 9.5 Në rast se kërkohet nga Autoriteti të vazhdoj periudhën kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave në mungesë të rrethanave, të specifikuar në nën-paragrafin 0) të këtij neni dhe gjatë këshillimit publik nuk janë pranuar komente të arsyetuara, vërejtje apo kundërshtime (*të cilat do të bënin të pamundshme shfrytëzimin e mëtejshëm të radio frekuencave*), të përmendur në nën-paragrafin 0) të këtij neni, sidoqoftë Autoriteti pranon një kundërshtim dhe personi kundërshtues gjithashtu dëshiron të shfrytëzoj radio frekuencat në fjalë dhe nuk ka mundësi për t'iu caktuar numër të mjaftueshëm të radio frekuencave të gjithë personave të cilët shprehin kërkesë që të përdorin radio frekuencat, Autoriteti, sipas iniciativës së vet e shpall një tender publik /ankand në pajtim me procedurat e përshkruara në paragrafin 3.7) të nenit 3 të kësaj Rregulloreje.
- 9.6 Në rast të tillë periudha kohore e shfrytëzimit të radio frekuencave për shfrytëzuesin kërkues do të vazhdohet derisa tenderi/ankandi publik të përfundoj. Në këtë rast, vazhdimi i tillë i përkohshëm nuk duhet të jetë më i gjatë se gjashtë (6) muaj por mundet të vazhdohet më tej vetëm për arsye të rëndësishme (*për shembull në rast të vonesave në procedura të tenderit/ankandit*) me afat maksimal prej çdo 2 muaj.

- 9.7 Autorizimi lëshohet në pajtim me dispozitat e paragrafëve 4.15) dhe 4.17 të nenit 4) të kësaj Rregulloreje. Autorizimi korrespondues do t'i përcillet aplikuesit brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga aprovimi i tij.

## Neni 10

### Transferimi i të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave

- 10.1 Shfrytëzuesi i radio frekuencave mund të transferoj të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave (*përfshirë transferimin e përkohshëm*) tek një person tjetër, përveç në rastet kur radio frekuencat janë caktuar për aktivitete në lidhje me mbrojtjen kombëtare, sigurimin kombëtar, mbajtjen e rendit publik, shërbimet emergjente publike, ruajtjen e kufijve shtetëror, aviacionin civil, sigurinë e trafikut hekurudhor, operimin stabil dhe të sigurt të sistemit të energjisë kombëtare dhe funksionet e tjera jo komerciale të shtetit (përfshirë shtetet e huaja) dhe institucionet e saja.
- 10.2 Nëse është vërtetuar që radio frekuencat janë shfrytëzuar në mënyrë jo efikase dhe jo efektive dhe/apo konkurrenca është shtrembëruar nga ndonjë transfer apo akumulim i të drejtave të shfrytëzimit të radio frekuencave, Autoriteti do të veproj konform paragrafëve 7) dhe 8) të nenit 54 të Ligjit.
- 10.3 Një shfrytëzues i radio frekuencave, i cili dëshiron të transferoj të drejtën e shfrytëzimit të tyre te një person tjetër duhet jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë para datës së skadimit të së drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave t'i paraqesë Autoritetit kërkesën e arsyetuar, të bashkëlidhur me dokumentet korresponduese që dëshmojnë arsyet për kërkesën e tillë. Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me pëlqimin e personit tek i cili kërkohet të bëhet transferi i të drejtës për të shfrytëzuar radio frekuencat.
- 10.4 Autoriteti mund të caktoj periudhën kohore prej dhjetë (10) ditë pune, gjatë së cilës shfrytëzuesi i radio frekuencave duhet të qartësoj apo ofroj informata shtesë, të nevojshme për marrjen e vendimit. Në rast se shfrytëzuesi dështon të qartësoj apo ofroj informatë shtesë brenda periudhës kohore të caktuar në paragrafin aktual, Autoriteti refuzon transferin e të drejtës për shfrytëzim të radio frekuencave tek një person tjetër.
- 10.5 Autoriteti brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditëve (*periudha kohore mund të zgjatet me një vendim të arsyetuar të Autoritetit*) pas pranimit të dokumenteve dhe informacioneve, të përmendur në paragrafët 10.3) dhe 10.4) të këtij neni, duhet të shqyrtoj kërkesën dhe të ndërmerr njërin nga veprimet në vijim, për të cilin shfrytëzuesi i radio frekuencave do të informohet brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditëve të punës;
- 10.5.1 Inicon procedurën e këshillimit publik në lidhje me vendimin për të lejuar transferin e të drejtës për të shfrytëzuar radio frekuencat tek një person tjetër;

- 10.5.2 Refuzon kërkesën për të lejuar transferin e të drejtës për shfrytëzimin e radio frekuencave tek një person tjetër, në cilindo nga rastet në vijim;
- 10.5.2.1 Autoriteti vërteton se kërkesa paraqet njërin nga rastet e përmendura në paragrafin 10.1) këtij Neni;
  - 10.5.2.2 Dokumentet e kërkuara, të cekura në paragrafin 10.3) të këtij Neni, nuk janë dorëzuar të kompletuara apo dokumentet e ofruara janë jo të sakta/me gabime, dështojnë të jenë në përputhje me kriteret e caktuara apo nuk janë sjell brenda periudhës kohore të caktuar nga Autoriteti;
  - 10.5.2.3 Transferimi i të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave do të rezultonte në probleme serioze ekonomike dhe/apo aktivitete të ndërlidhura me persona të tjerë, që kanë ndikim negativ domethënës në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe/apo shtrembërojnë konkurrencën apo janë në kundërshtim me kriteret e kërkuara nga aktet ligjore, që rregullojnë aktivitetet e komunikimeve elektronike. Në rastet e tilla Autoriteti duhet të specifikoj arsyet për refuzimin e kërkesës;
  - 10.5.2.4 Personi, tek i cili kërkohet të transferohet e drejta për shfrytëzimin e radio frekuencave, në pajtim me aktet ligjore korresponduese nuk mund të jetë shfrytëzues i radio frekuencave.
- 10.6 Pas përfundimit të këshillimit publik të përmendur në paragrafin 10.5.1) të këtij Neni, sidoqoftë jo më vonë se deri në datën e skadimit të periudhës kohore të shfrytëzimit të radio frekuencave korresponduese, Autoriteti do të marrë njërin nga vendimet në vijim, duke e njoftuar shfrytëzuesin brenda një periudhe kohore prej dhjetë (10) ditëve të punës nga data e fuqizimit të vendimit;
- 10.6.1 Të lejoj transferimin e të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave te personi tjetër dhe të caktoj kushtet për transfer. Personit, tek i cili transferohet e drejta për shfrytëzim të radio frekuencave, do ti lëshohet fatura për marrjen e autorizimit, e cila duhet të paguhet brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditëve nga data e dorëzimit të faturës;
  - 10.6.2 Duke marrë parasysh komentet, vërejtjet apo kundërshtimet e arsyetuara gjatë këshillimit publik të refuzoj transferimin e drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave te personi tjetër.
- 10.7 Pasi shfrytëzuesi i radio frekuencave dhe personi të cilit kërkohet t'i transferohet e drejta e shfrytëzimit të radio frekuencave, i përmbushin kushtet për transferim të caktuar në nën-paragrafin 10.6.1) të këtij neni, Autoriteti i lëshon autorizimin personit të cilit e drejta për shfrytëzimin e radio frekuencave i është transferuar dhe e anulon autorizimin e shfrytëzuesit të mëparshëm të radio frekuencave.

- 10.8 E drejta për të shfrytëzuar radio frekuencat si dhe obligimet e ndërlidhura me shfrytëzimin e tyre i kalojnë personit, tek i cili është transferuar e drejta për të shfrytëzuar radio frekuencat, duke filluar nga data e lëshimit të autorizimit, të përmendur në paragrafin 10.7) të këtij neni në rast se nuk është paraparë ndryshe sipas ndonjë dispozite në autorizim.
- 10.9 Me vendim të tij Autoriteti mund të refuzoj lëshimin e autorizimit personit, të cilit është kërkuar t'i transferohet e drejta për shfrytëzimin e radio frekuencave dhe/apo të anuloj vendimin korrespondues për të lejuar transferimin e të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave, në ndonjërin prej rasteve në vijim;
- 10.9.1 Shfrytëzuesi i radio frekuencave apo personi, të cilit është kërkuar t'i transferohet e drejta për shfrytëzimin e radio frekuencave ka dështuar t'i përmbush kushtet, të caktuara me vendim të Autoritetit për të lejuar transferimin e të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave;
- 10.9.2 Personi të cilit është kërkuar t'i transferohet e drejta për shfrytëzimin e radio frekuencave ka dështuar të paguaj faturën për lëshimin e autorizimit brenda periudhës kohore, të caktuar në paragrafin 10.6.1) të kësaj Rregulloreje.

## **Neni 11**

### **Pezullimi / anulimi i të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave dhe ndërrimi i parametrave teknik të radio frekuencave**

- 11.1 Në rastet objektivisht të arsyetuara, në lidhje me efikasitetin e shfrytëzimit të radio frekuencave apo sigurimin e kompatibilitetit elektromagnetik, në pajtim me Nenin 54.5) të Ligjit, Autoriteti, me iniciativë të vetën ka të drejtë të ndërroj radio frekuencën që i është caktuar shfrytëzuesit, me një tjetër radio frekuencë për përdorime të ngjashme, me ç'rast shfrytëzuesi i radio frekuencës do të njoftohet me kohë. Në këtë rast shfrytëzuesi i radio frekuencës nuk do të paguaj pagesat e rregullta (pagesën administrative) të aplikueshme për ndryshimin e parametrave teknik të radio frekuencave.
- 11.2 Në rastet, e përshkruara në paragrafin 11.1) të këtij Neni, Autoriteti e informon me shkrim shfrytëzuesin e radio frekuencës, duke specifikuar; arsyet për ndryshimin e paraparë të radio frekuencës me një frekuencë tjetër për përdorime të ngjashme, radio frekuencën e re të ofruar, datën e fillimit të shfrytëzimit të radio frekuencës, si dhe kushtet e tjera dhe caktimin e periudhës kohore, gjatë të cilës shfrytëzuesi i radio frekuencës duhet të shpreh mendimin e vet lidhur me ndërrimin e radio frekuencës aktuale me një frekuencë tjetër të qëllimit të njëjtë të ofruar nga Autoriteti.
- 11.3 Autoriteti do të vendos (*nëse do duhet të zëvendësoj apo jo*) në lidhje me zëvendësimin e radio frekuencës së përcaktuar nga Autoriteti me një radio frekuencë të qëllimit të njëjtë jo më vonë se deri në skadim të periudhës kohore të shfrytëzimit të radio frekuencës.

- 11.4 Autorizimi për të shfrytëzuar radio frekuencën e re/të ndërruar do të lëshohet jo më vonë se brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditëve të punës prej datës së marrjes së vendimit nga Autoritetit për të zëvendësuar radio frekuencën e përcaktuar për shfrytëzuesin me një frekuencë tjetër të qëllimit të ngjashëm.
- 11.5 Autoriteti, gjatë marrjes së vendimit për të zëvendësuar radio frekuencën e përcaktuar për shfrytëzuesin me një frekuencë tjetër, ne analizën e arsyeshmerisë dhe kushteve teknike, mund të lejoj shfrytëzuesin të shfrytëzoj të dyja radio frekuencat në të njëjtën kohë, për periudhën kohore jo më gjatë se gjashtë (6) muaj prej datës së lejimit të së drejtës për zëvendësim e radio frekuencës, varësisht nga arsyeshmëria dhe kushtet teknike.
- 11.6 Në rast të shkeljes së rëndë apo të përsëritur të kushteve për të shfrytëzuar radio frekuencat, kur masat e ndërmarra në pajtim me paragrafin 7.5 të Nenit 7 të kësaj Rregulloreje kanë qenë të pa-mjaftueshme për rregullimin e shkeljeve, Autoriteti ka të drejtë që me vendim të tij të pezulloj/ndërpresë të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencës për periudhën kohore prej deri në tre (3) vjet apo të anuloj të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencës
- 11.7 Shfrytëzuesi i radio frekuencës mund të refuzoj radio frekuencën e caktuar duke i ofruar Autoritetit një njoftim me shkrim mbi arsyeshmërinë e refuzimit.
- 11.8 Autorizimi për të shfrytëzuar radio frekuencën do të anulohet në rastet si në vijim;
- 11.8.1 Autoriteti e pranon kërkesën e shfrytëzuesit të radio frekuencës për refuzim të autorizimit dhe Autoriteti vendos të anuloj autorizimin për shfrytëzimin e radio frekuencës;
- 11.8.2 Autoriteti e ka zëvendësuar të drejtën për shfrytëzim të radio frekuencës nga një radio frekuencë tjetër në pajtim me paragrafin 5) të nenit 54 të Ligjit;
- 11.8.3 Autoriteti e revokon radio frekuencën e caktuar në pajtim me paragrafin 5) të nenit 54 të Ligjit në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga obligimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, aktet ligjore të Bashkësisë Evropiane, apo nëse qëllimi për shfrytëzimin e resurseve të komunikimeve elektronike është ndryshuar. Në rast të tillë shfrytëzuesi i radio frekuencës duhet të kompensohet për pagesat që ai tashmë i ka bërë për shfrytëzim të radio frekuencës/kanalit në mënyrë proporcionale (*që do të thotë në proporcion me kohën e shfrytëzuar*), përveç për pagesat fillestare që nuk zbriten nga pagesa;
- 11.8.4 Nëse ekziston mundësi teknike që radio frekuenca e revokuar të zëvendësohet me një tjetër duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të njëjta, kompensimi i pagesës mund të mos aplikohet ose të aplikohet në proporcion me resursin frekuencor (*kohën, rangun dhe kapacitetin frekuencor*) të zëvendësuar.
- 11.8.5 Periudha kohore e të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencës skadon.



## Neni 12

### **Caktimi dhe shfrytëzimi i radio frekuenca, të nevojshme për aktivitetet, në lidhje me funksionet jo komerciale të shtetit dhe institucioneve të saja**

- 12.1 Radio frekuencat, të nevojshme për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e shtetit, mbajtjen e rendit publik, shërbimet publike emergjente, mbrojtjen e kufijve shtetëror, aviacionin civil, sigurinë e trafikut hekurudhor, operimin e sigurt dhe stabil të sistemit energjetik dhe funksioneve të tjera jo komerciale të shtetit (përfshirë shtetet e huaja) dhe institucionet e tij, Autoriteti do t'i caktoj në përputhje me Planin Kombëtar të Radio Frekuencave, ashtu që kërkesat e tyre për radio-frekuenca do të shqyrtohen me prioritet në funksion të mundësive teknike dhe kapaciteteve frekuencore në dispozicion. Shfrytëzimi i këtyre kanaleve frekuencore duhet të bëhet në mënyrë efikase dhe efektive, duke siguruar kualitetin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shmangur interferencat e dëmshme, konform paragrafëve 2.2) dhe 4) të nenit 46 të Ligjit.
- 12.2 Radio frekuencat për aktivitetet, në lidhje me funksionet tjera jo komerciale të shtetit (përfshirë shtetet e huaja) dhe institucionet e tij, në rast se nevojiten radio frekuencat/stacionet e tilla, në lidhje me aktivitetet e misionëve diplomatike dhe institucioneve konsullore të Kosovës dhe shteteve të huaja, siguria e vizitorëve zyrtarë të Republikës së Kosovës, zbutja e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe operacioneve emergjente në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare janë caktuar në pajtim me dispozitat e këtij seksioni. Në rast të nevojës objektive, Autoriteti do t'i caktoj radio frekuencat në përputhje me Planin Kombëtar, ashtu që kërkesat e tyre për radio frekuenca duhet të shqyrtohen me prioritet në funksion të mundësive teknike dhe kapaciteteve frekuencore në dispozicion dhe shfrytëzimi i tyre nuk do të sjell interferenca të dëmshme në sistemet e radio komunikimeve që operojnë në mënyrë legjitime.
- 12.3 Aplikuesi, i cili kërkon t'i caktohet një radio frekuencë do të aplikoj tek Autoriteti me kërkesë të arsyetuar, e cila përmban si në vijim;
- 12.3.1 Arsyet për pamundësinë për të caktuar radio frekuencat e kërkuara në pajtim me procedurën, të caktuar në Nenin 4) të kësaj Rregulloreje, e shoqëruar me dokumentet shoqëruese, që dëshmojnë numrin e radio frekuencave të kërkuara, të nevojshme për aktivitetet dhe apo gjerësinë e brezit të radio frekuencës;
- 12.3.2 Shfrytëzuesi i ardhshëm i radio frekuencës apo brezit të radio frekuencës;
- 12.3.3 Informata, e specifikuar në paragrafët 4.2) të nenit 4) të kësaj Rregullore.
- 12.3.4 Periudha kohore nuk do të jetë më pak se një (1)muaj.
- 12.4 Gjatë shqyrtimit të kërkesave të aplikuesit për caktimin e radio frekuencave apo brezit të radio frekuencave, dispozitat e nën-paragrafit 4.4.1), dhe paragrafëve 4.5);, 4.6);, 4.7);, 4.13);, 4.14);, 4.15);, 4.16); dhe 4.17);, të nenit 4) të kësaj Rregulloreje do të aplikohen tek aktivitetet të cilat janë specifikuar në paragrafët 12.1) dhe 12.2) të këtij neni.

- 12.5 Autoriteti mund të refuzoj caktimin e radio frekuencës mbi arsyet, të specifikuara në nën-paragrafin 4.4.4) të nenit 4) të kësaj Rregullore apo në rastet në vijim;
- 12.5.1 Kërkesa është paraqitur nga një institucion, jo i specifikuar në paragrafët 12.1) dhe 12.2) të këtij neni;
- 12.5.2 Aktivitetet, për të cilat radio frekuencat janë kërkuar nuk janë të ndërlidhura me mbrojtjen e sigurisë së shtetit, mbajtjen e rendit publik, shërbimet emergjente shtetërore, ruajtjen e kufirit shtetëror, aviacionin civil, sigurinë e trafikut hekurudhor dhe sigurimin e funksionimit stabil dhe të besueshëm të sistemit të energjisë, zbutjen e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe operacioneve emergjente në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare dhe funksionet e tjera jo komerciale të shtetit (përfshirë shtetet e huaja) dhe institucionet e saja apo Autoriteti vendos nëse radio frekuencat mund të caktohen dhe shfrytëzohen në pajtim me procedurën, të paraparë në Nenin 3) të kësaj Rregullore;
- 12.6 Radio frekuencat, të caktuara në pajtim me dispozitat e nenit 12), do të përdoren në përputhje me kushtet e specifikuara në këtë Rregullore, ndryshimi i kushteve teknike dhe anulimi i tyre do të behet në pajtim me procedurat, të parapara në nenet 3), 7), 8), 9) dhe 11) të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 13**

#### **Caktimi i radio frekuencave për qëllime të shfrytëzimit jo komercial eksperimental**

- 13.1 Në rast se ka radio frekuenca të pa-caktuara brenda brezave të radio frekuencave në Planin për Shfrytëzim të Radio Frekuencave, të quajtura; 'Numri i autorizimeve për shfrytëzim të radio frekuencave është i kufizuar' apo 'i rezervuar', apo në rast se procedurat për caktimin e radio frekuencave kanë filluar, megjithatë radio frekuencat nuk janë caktuar, radio frekuencat e tilla mund t' u caktohen aplikantëve, të cilët paraqesin kërkesa për caktim të radio frekuencave për qëllime të shfrytëzimit jo komercial eksperimental, në rast se kjo nuk është në konflikt me planet e zhvillimit të radio frekuencave dhe aktet e tjera ligjore. Radio frekuencat e tilla do të caktohen, shfrytëzohen, kushtet për shfrytëzim të tyre do të ndryshohen dhe caktimi i radio frekuencave do të pezullohet në pajtim me procedurën, të caktuar në këtë rregullore, në rast se nuk është paraparë ndonjë dispozitë tjetër në Nenin aktual për këtë çështje.
- 13.2 Gjatë paraqitjes së kërkesës, aplikuesit duhet të specifikoj qëllimin e eksperimentit.
- 13.3 Radio frekuencat për qëllime të shfrytëzimit jo-komercial eksperimental caktohen drejtpërdrejt aplikuesit pa aplikuar ndonjë procedurë të tenderit publik/ ankandit tek aplikanti.
- 13.4 Autoriteti e cakton numrin e radio-frekuencave të nevojshme për kryerjen e eksperimentit specifik.
- 13.5 Radio frekuencat, të kualifikuara si të kufizuara ku numri i autorizimeve për shfrytëzim të radio frekuencave është i kufizuar sipas vendimit-eve të Autoritetit apo me/sipas Planit për

Shfrytëzim të Radio Frekuencave, sidoqoftë frekuencat jo të rezervuara mund të caktohen sipas vendimit të Bordit për qëllimet e shfrytëzimit jo komercial eksperimental për periudhën kohore jo më gjatë se gjashtë (6) mujore.

- 13.6 Periudha kohore e shfrytëzimit të radio frekuencave, e caktuar në pajtim me dispozitat e paragrafit 13.5) mund të mos vazhdohet nga Autoriteti dhe Autoriteti e mban të drejtën ligjore të ndërpresë në çdo kohë shfrytëzimin e radio frekuencave të lejuar për qëllime eksperimentale nëse, deformatojnë tregun e komunikimeve elektronike apo shfaqen interferenca tek shfrytëzuesit e tjerë.
- 13.7 Aplikuesi nuk lejohet të pranoj ndonjë shpërblim (kompensim financiar) për shërbimet e ofruara për shfrytëzim të radio frekuencave, të caktuara në pajtim me dispozitat e paragrafit 13.5).
- 13.8 Radio frekuencat, të shfrytëzuara për qëllime të shfrytëzimit jo komercial eksperimental nuk duhet të shkaktojnë ndonjë radio interferencë tek shfrytëzuesit e tjerë legjitim të radio frekuencave dhe duhet garantuar nga radio interferencat, e shkaktuara nga stacionet e tjera të radio komunikimeve.

#### **Neni 14**

##### **Pagesat në lidhje me caktimin, ndryshimin apo shfrytëzimin e radio frekuencave**

- 14.1 Shfrytëzuesi potencial apo ekzistues i radio frekuencave duhet të kompletoj pagesat për/sipas përcaktimeve të caktuara nga Autoriteti para përcaktimit, ndryshimit apo bartjes së të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave si në vijim;
  - 14.1.1 Taksat administrative për dhënien e Autorizimit të paraqitura në Shtojcën 1) të kësaj Rregulloreje;
  - 14.1.2 Taksat për dhënien të Autorizimit, para lëshimit të autorizimit për fituesin e tenderit publik/ankandit;
  - 14.1.3 Pagesat vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave të caktuara, të paraqitura në Rregullore mbi Pagesat për Shfrytëzim të Radio Frekuencave.
- 14.2 Autoriteti ndërmerr veprimet e duhura në lidhje me caktimin apo ndryshimin e të drejtës së shfrytëzimit të radio frekuencave vetëm në rastet kur të gjitha pagesat e kërkuara janë realizuar dhe dëshmia e një pagese të tillë iu është ofruar Autoritetit. Për këtë qëllim Autoriteti lëshon një faturë përkatëse e cila duhet të paguhet brenda kushteve të specifikuara me këtë Rregullore.
- 14.3 Në rast se shfrytëzuesi ekzistues i radio frekuencave dështon të realizojë me kohë pagesën e kërkuar, Autoriteti do ti caktojë një pagesë shtesë me vlerë prej 10% të pagesës bazë dhe do të

vazhdoj periudhën e pagesës për tridhjetë (30) ditë shtesë. Në një rast të tillë Autoriteti lëshon një faturë shtesë për masën e sanksionit ekonomik.

Nëse edhe pas këtyre afateve kohore nuk realizohen pagesat, atëherë Autoriteti ndaj këtyre shfrytëzuesëve të radio frekuencave shqipton sanksionet ekonomike sipas dispozitave të neneve 99, 101, 102 dhe 103 të Ligjit dhe rregulloreve të aplikueshme.

- 14.4 Shfrytëzimi i përkohshëm i radio frekuencave të caktuara me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme apo ndonjë institucion tjetër relevant, gjatë vizitave zyrtare të bëra nga përfaqësuesit e shteteve të huaja në Republikën e Kosovës lirohen nga çdo pagesë të paraqitur në paragrafin 14.1) të këtij neni.
- 14.5 Për pagesat vjetore të caktuara sipas nën-paragrafit 14.1.3) të këtij neni, është paraparë lirimi i plotë apo i pjesshëm nga detyrimi i pagesës vjetore për shfrytëzimin e radio-frekuencave për kategoritë e mëposhtme të shfrytëzuesëve të radio frekuencave;
  - 14.5.1 Shfrytëzuesit jo-komercial të radio frekuencave të caktuara në sistemet PMR për institucionet publike të kujdesit shëndetësor me pronësi të sistemit të shëndetit kombëtar të Kosovës, janë përfitues të lirimt të plotë nga pagesa e mbikëqyrjes;
  - 14.5.2 Institucionet shtetërore që shfrytëzojnë radio frekuencat për aktivitetet e ndërlidhura me mbrojtjen dhe sigurinë e shtetit, mbajtjen e rendit publik, shërbimet emergjente, ruajtjen e kufirit shtetëror, të cilat Autoriteti i konsideron mirë të arsyetuara, janë përfitues të lirimt të plotë nga pagesa e mbikëqyrjes;
  - 14.5.3 Pagesa vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave të caktuara për institucionet shtetërore të cilat nuk kryejnë aktivitete të parapara sipas nën-paragrafit 14.5.2), si institucionet arsimore dhe shkencore publike jo komerciale, të cilat përdorin radio frekuencat për qëllime arsimore, shkencore, të trajnimit, organizatat jo-qeveritare që nuk kryejnë aktivitete komerciale, do të përfitojnë nga lirimi i pjesshëm respektivisht zbritja në masën prej 50% të pagesës së rregullt vjetore të mbikëqyrjes;
- 14.6 Procedura e pagesave vjetore periodike për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave të caktuara, të përmendura në paragrafin 14.1.3) të këtij Neni, do të jenë si në vijim;
  - 14.6.1 Pagesat vjetore periodike duhet paguar në bazë vjetore, përveç në rastet e parapara në nën-paragrafët 14.5.1) dhe 14.5.2) të këtij neni. Kur shfrytëzuesi i frekuencave aplikon për Autorizim me vlefshmëri më të gjatë se një (1) vit, një muaj para përfundimit të afatit një vjeçar të autorizimit, Autoriteti i lëshon faturën për pagesën vjetore për periudhën vijuese e cila duhet të realizohet konform nën-paragrafit 14.6.5).

Me kërkesë të shfrytëzuesit të frekuencave, Autoriteti mund të lejon pagesën për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave për periudhën kohore për periudha kohore më të gjata se një (1) vit por JO më shumë se katër (4) vite.

- 14.6.2 Pagesat vjetore do të kalkuloohen në bazë të vitit kalendarik. Në rast se autorizimi i ri duhet të jepet në pajtim me këtë Rregullore, pagesat vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave të caktuara do të përfshihen në faturë së bashku me taksat administrative me një pagesë të vetme, të përmendura në nën-paragrafin 14.1.1) të këtij neni dhe duhet të paguhet para lëshimit të autorizimit;
- 14.6.3 Në raste të kërkesës se një shfrytëzuesi të radio frekuencave për bashkim të disa Autorizimeve në një të vetëm, Autoriteti mund të aprovoj një kërkesë të tillë, ashtu që pagesa për mbikëqyrje të radio frekuencave për autorizimet valide të mëhershme që do të bashkohen, do të përlogaritet në baza mujore për diferencën e periudhës kohore në mes autorizimeve.
- 14.6.4 Pagesa vjetore për shfrytëzim të radio frekuencave për rastet konform nën-paragrafit 4.2.1), do të jetë në proporcion me periudhën e shfrytëzimit të shërbimit dhe vlerës së pagesës vjetore;
- 14.6.5 Fatura duhet të paguhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës, përveç nëse është e specifikuar afat tjetër nga Autoriteti;

## **Neni 15**

### **Dispozitat përfundimtare**

- 15.1 Shfrytëzuesi i radio frekuencave duhet të jetë i përgjegjshëm në pajtim me procedurat të parapara me legjislacionin në fuqi, duke mos shkaktuar ndonjë shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje apo të ndonjë akti tjetër ligjor.
- 15.2 Në rast se Autoriteti vërteton që shfrytëzuesi i radio frekuencave ka qenë duke i përdorur radio frekuencat pa autorizim, përveç për rastet e specifikuar në paragrafin 4) të nenit 3) të kësaj Rregulloreje, Autoriteti ka të drejtën e caktimit të masës së sanksionit ekonomik për shfrytëzim të radio frekuencave pa siguruar autorizimin paraprak nga Autoriteti. Masa sanksionuese do të caktohet në pajtim me dispozitat e Kreut XVI) të Ligjit dhe rregulloreve të aplikueshme.
- Caktimi i një mase sanksionuese nuk nënkupton të drejtën e vazhdimit të shfrytëzimit të radio frekuencave të përmendura më sipër pa-autorizim përkatës të dhënë nga Autoriteti, e as nuk konsiderohet të jetë pagesë e bërë për shfrytëzim të radio frekuencave.
- 15.3 Veprimet apo lëshimet e kryera nga zyrtarët e Autoritetit në zbatim të kësaj Rregulloreje konform procedurave të rregullta mund të ankimohet para Bordit të Autoritetit apo institucioneve të gjyqësorit të vendit, në pajtim me procedurat e parapara me ligjet në fuqi.
- 15.4 Autorizimet e dhëna drejtpërdrejt personit (aplikuesit) që i kërkon dhe ato që nuk janë subjekt i kufizimeve të vendosura sipas Vendimeve të Autoritetit sipas rekomandimit nga bartësi i përgjegjësishë pranë Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave nuk janë subjekt i shqyrtimit

në mbledhjet e Bordit dhe vendimit-eve nga Bordi dhe autorizohen drejtpërsëdrejti nga Kryetari i Bordit.

- 15.5 Me miratimin e kësaj Rregulloreje shfuqizohen aktet e mëposhtme rregullatore;
- 15.5.1 Rregullorja mbi Dhënien e Licencës për të Drejtën e Shfrytëzimit të Radio Frekuencave (Ref. Nr. 008/08, i datës 10 janar 2008)
- 15.5.2 Vendimi i Bordit të Autoritetit Nr. 27, i datës; 26 gusht 2010 që ka ndryshuar dhe plotësuar Rregulloren Nr. 008/08; dhe
- 15.5.3 Udhërrëfyesin e Brendshëm të miratuar sipas pëlqimit të Bordit të Autoritetit Nr. 044/B/11, i datës; 26 korrik, 2011 mbi administrimin e proceduarave të radio frekuencave në DMF.

## **Neni 16** **Hyrja në fuqi**

- 16.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e saj të miratimit nga Bordi i Autoritetit dhe mbetet në fuqi deri në nxjerrjen (adoptimin) e ndonjë rregullore tjetër nga Bordi i Autoritetit.
- 16.2 Shtojcat I) deri VI) janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

**Klasa: 01/13**

**Nr. Regj. 22**

**Prishtinë, 31/12/2013**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Ekrem Hoxha**  
**Kryetar i Bordit**



Rregullat për Caktimin dhe Shfrytëzimin e Radio frekuenca

**Lista e pagesës së njëhershme të taksës administrative në lidhje me caktimin dhe ndryshimin e autorizimeve për të shfrytëzuar radio frekuencat**

Nr.	Përshkrimi i taksës	Vlera NETO /€
<b>Taksat për <u>caktimin e kushteve</u> për të shfrytëzuar radio frekuencat:</b>		
<b>1.</b>	<b>Kur numri i autorizimeve nuk është i kufizuar (sipas kanalit)</b>	
1.1.	Për 1 kanal simpleks	5.00 €
1.2.	Për 2 deri në 3 kanale simplekse (apo 1 semi-dupleks dhe 1 simpleks)	10.00 €
1.3.	Për 4 deri në 10 kanale simplekse	20.00 €
1.4.	Për 11 deri në 50 kanale simplekse	50.00 €
1.5.	Mbi 50 kanale simplekse	100.00 €
<b>2.</b>	<b>Kur numri i autorizimeve është i kufizuar:</b>	
2.1.	Për autorizim	75.00 €
<b>3.</b>	<b>Taksat për <u>ndryshimin e kushteve</u> për shfrytëzim të radio frekuencave (kanaleve) sipas kërkesës të personit të autorizuar, (për rrjetet e shërbimeve fikse dhe mobile, sipas autorizimit)</b>	15.00 €
<b>4.</b>	<b>Taka për caktimin e kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave (kanaleve) në rast të bartjes së të drejtës për të shfrytëzuar radio frekuencën (kanalin) tek personi tjetër (sipas autorizimit).</b>	20.00 €

## Rregullat për Caktimin dhe Shfrytëzimin e Radio Frekuenca

(emri dhe numri i regjistrimit të personit juridik apo emri dhe mbiemri i personit fizik)

(adresa e postës)

(numri i telefonit, numri i faksit, e-mail adresa)

Për: Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Kosovës  
Qyteza Pejton, Rr.Pashko Vasa nr. 12, 10 000 Prishtina  
Tel.: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399; E-mail: [info@arkep-rks.org](mailto:info@arkep-rks.org) ;

### KËRKESË PËR SHFRYTEZIM TË RADIO FREKUENCAVE

Data: \_\_\_\_\_ Nr. \_\_\_\_\_

Përmes kësaj kërkojmë nga autoriteti i lartpërmendur:

- a) Caktimin e radio frekuencës / radio frekuencave .....   
(Nevojiten te gjitha dokumentet e nevojshme te specifikuara ne piken I)
- b) Ndryshimin e kushteve për shfrytëzim të radio frekuencave.....   
(Nga dokumentet e nevojshme kërkohet vetëm 'Forma e aplikacionit e plotësuar' I(1))
- c) Vazhdimin e afatit për shfrytëzim të radio frekuencave.....   
(Nga dokumentet e nevojshme kërkohet vetëm 'Forma e aplikacionit e plotësuar' I(1))

për autorizimin e lëshuar paraprak me Nr. \_\_/\_\_/ \_\_\_\_, me vlefshmëri deri me \_\_/\_\_/ \_\_\_\_.  
Kohëzgjatja e dëshiruar e përdorimit të kanalit/ kanaleve frekuencore apo brezit frekuencor është  
prej: \_\_\_\_\_ (ddmmvv) deri me \_\_\_\_\_ (ddmmvv). (plotesimi i ketij paragrafi vlen vetem  
per rastet nën b dhe c)

#### I. DOKUMENTET E NEVOJSHME TE BASHKËLIDHURA ME KERKESEN<sup>1</sup>

1. Forma e aplikacionit (tabela e aplikimeve) e plotësuar në dy kopje...
2. Certifikata e regjistrimit dhe dokumentacioni i funksionimit te subjektit juridik .....
3. Certifikata e regjistrimit te biznesit dhe informata mbi biznesin.....
4. Kopja e Licencës nga KPM (për shërbimet Radio dhe TV) .....
5. Autorizimi i përgjithshëm për operim i dhënë nga ARKEP -i, për ofrues të shërbimeve të telekomunikacionit.....
6. Licenca për operim e lëshuar nga MPB, për ofrues të shërbimeve të sigurimit privat.....

Vërejtje shtesë;

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

(titulli i drejtuesit të aplikantit apo  
personi i tij/saj i autorizuar)

(emri dhe mbiemri)

(vula)

(nënshkrimi)

<sup>1</sup> Kopjet e dokumenteve te kerkuara duhet te kene te bashkengjitura edhe dokumentet origjinale, vetem per shikim/verifikim

## FORMA E APLIKIMIT PER FREKUENCË

Njësia kërkuese/Organizata	
Pika e kontaktit, Adresa	
Tel. No./Fax. No./E-Mail	

### SPECIFIKIMET E TË DHËNAVE:

010. LLOJI I VEPRIMIT (N=KËRKESE E RE; =RIPËRTËRIRJE)	
102. NUMRI SERIK I AGJENSIONIT (Procesues) (*)	
110. FREKUENCA E KËRKUAR (Range/No./Separation)	
113. KLASA E STACIONIT (Fikse/Mobile);	
114. GJERËSIA E BREZIT DHE PËRCAKTIMI I TRANSMETIMIT	
115. FUQIA E TRANSMETUESIT (ne Wat)	
130. KOHËZGJATJA E PËRDORIMIT	
140. DATA E FILLIMIT (*)	
141. DATA E SKADIMIT (*)	
205. TIPI I AGJENSIONIT (*)	
207. NJËSIA OPERUESE	

### STACIONI A

300. SHITETI KU NDODHET STACIONI TRANSMETUES Tx	
301. LOKACIONI I ANTENËS Tx (Emri i Sajtit)	
303. KOORDINATAT E ANTENËS Tx (Six-Figure Grids)	
306. RREZEVEPRIMI I AUTORIZUAR (në kilometra)	
340. FORMA DHE MODELI I PAJISJES	
354. FORMA, LLOJI DHE MODELI I ANTENËS	
356. LARTËSIA E ANTENËS (në metra mbi nivelin e tokës)	
357. PËRFORCIMI I ANTENËS (në dB)	
360. GJERËSIA E TUFËS SË ANTENËS (H/V)	
362. ORIENTIMI I ANTENËS (V/H)	
363. POLARIZIMI I ANTENËS	

### STACIONI B

400. SHITETI KU NDODHET STACIONI PRANUES Rx	
401. LOKACIONI I ANTENËS Rx (Emri i Sajtit)	
403. KOORDINATAT E ANTENËS Rx (Six-Figure Grids)	
440. FORMA DHE MODELI I PAJISJES	
454. FORMA, LLOJI DHE MODELI I ANTENËS	
456. LARTËSIA E ANTENËS (në metra mbi nivelin e tokës)	
457. PËRFORCIMI I ANTENËS (në dB)	
460. GJERËSIA E TUFËS SE ANTENËS (H/V)	
462. ORIENTIMI I ANTENËS (V/H)	
463. POLARIZIMI I ANTENËS	

501. KOMENTE (*)	
502. NUMRI IDENTIFIKUES I GRUPIT (nëse nevojitet) (*)	
520. FREKUENCA DUPLKSE QIFTOHET ME (*)	
704. LLOJI I SHËRBIMIT (S=Simplex; D=Duplex; H=Semi-Duplex)	
801. ARSYETIMI (qëllimi i kërkesës për frekuencë)	
803. PERSONI KONTAKTUES (emri, numri i telefonit)	
804. INKREMENTI I AKORDIMIT	
996. LLOJI I QARKUT (RPTR, LOS, M-LINK, B'CAST, CNR)	

(\*) - Këto fusha duhet te plotësohen nga zyrtaret e ARKEP

Print (emri, mbiemri): \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i aplikuesit: \_\_\_\_\_

ata e pranimit në ARKEP: \_\_\_\_\_

Pranuar nga \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Faqe 29 nga 30

Adresa: Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;

E-mail: [info@arkep-rks.org](mailto:info@arkep-rks.org); web-site: [www.arkep-rks.org](http://www.arkep-rks.org)

## FORMA E APLIKIMIT PËR AUTORIZIM INDIVIDUAL TË SHËRBIMEVE SATELITORE

<b>TË DHËNAT ADMINISTRATIVE:</b>	
Emri Ndërmarrjes/Organizatës:	
Adresa:	
Numri i tel./fax:	
E-mail adresa	
Personi i kontaktit	
<b>Arsyetimi</b> (Qëllimi i kërkesës):	_____
<b>TË DHËNAT TEKNIKE:</b>	
Organizata satelitore:	
Frekuenca:	Brezi: _____ Rangu: _____ Uplink (Tx): _____ Downlink (Rx): _____
Stacioni satelitor tokësor:	Pajisja: _____ Modeli _____ Vendi: _____ Longituda: _____ Latituda: _____ (6-Figure Grid)
Pozita orbitale e Satelitit:	
ID/Lokacioni i Transponderit të shfrytëzuar:	
Gjersia e brezit dhe përcaktimi i transmetimit:	
Fuqia:	Fuqia e transmetimit: _____ W; EIRP: _____ W
Antena e shfrytëzuar Tx:	Pajisja: _____ Tipi: _____ Përforcimi: _____ dB Modeli: _____ Madhësia: _____ Lartësia: mbi tokë: _____ m; mbi nivelin zero: _____ m
Antena e shfrytëzuar Rx:	Pajisja: _____ Tipi: _____ Përforcimi: _____ dB Modeli: _____ Madhësia: _____ Lartësia: mbi tokë: _____ m; mbi nivelin zero: _____ m
Gjerësia e tufës së antenës (H/V):	Tx: _____ shkallë; Rx: _____ shkallë
Orientimi i antenës (V/H):	Tx: _____ shkallë; Rx: _____ shkallë
Polarizimi i antenës:	Tx: _____ Rx: _____
Të dhënat tjera shtesë:	_____

Ne deklarojmë se ky **Rrjet i Radio komunikimit** do të transmetojë **zë / të dhëna / video**, për përdorime civile (publike, private ose humanitare), dhe nuk do të jetë i lidhur me ndonjë Rrjet Publik të Telekomunikacionit (PSTN).

Kërkuesi (Emri, Mbiemri): \_\_\_\_\_ Data e pranimit: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi: \_\_\_\_\_